



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:260520

Datë: 30.06.2020

Numri i dokumentit: 00997212

A.nr.1012/16

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për çështje administrative, Divizioni Fiskal, me gjyqtarin Krenar Berisha, dhe me sekretaren juridike Nazife Sheholli, në konfliktin administrativ, të paditëses “T.” Ndërmarrje në Administrim të AKP-së kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike: vlerësim tatimor, në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 22.06.2020, në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palës paditëse, e në mungesë të palës së paditur, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET Kërkesëpadia e paditëses “T.” Ndërmarrje në Administrim të AKP-së , si e pabazuar

Mbetet në fuqi vendimi nr.87/2016 i datës 23.05.2016 i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë.

A R S Y E T I M

Me vendimin kontestues e paditura Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë (ATK) ka refuzuar ankesën e paditëses dhe i ka konfirmuar si të bazuara Njoftim Rivlerësimet e tatimit shtesë të caktuara me kontroll.

Paditësja “T.” Ndërmarrje në Administrim të AKP-së, me padinë e paraqitur në Gjykatë me datë 01.07.2016, ka inicuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar nga gjykata aprovimin e padisë si të bazuar dhe anulimin e vendimit të paditurës nr.87/2016 i datës 23.05.2016 si i kundërligjshëm dhe paditësi të lirohet nga ngarkimi me Njoftim shtesë sipas Njoftimit për Rivlerësim.

Në padinë e tij dhe përmes përfaqësuesit të autorizuar në seancën e shqyrtimit kryesor paditësja ka deklaruar se padia paraqitet për shkak të mos aplikimit të drejt të dispozitave ligjore dhe mos vërtetimit të drejt të gjendjes faktike. Raporti i Kontrollit dhe Njoftimi për Rivlerësimin e Tatimit kanë vendosur të mos njohin shpenzime të cilat rrjedhin nga faturat e rregullta, duke rritur kështu në mënyrë të parregullt bazën e tatueshme për tatimin në të hyra të Korporatës, duke mos lejuar aplikimin e TVSH-së së zbritshme në pajtim me legjislacionin në fuqi. Në formë të përmbledhur përmes vendimit të atakuar, ATK-ja nuk i njeh paditëses shpenzimet legjitime në vlerë prej afërsisht 3.6 milion, për vitin 2014, dhe afërsisht 800.000,00€ për vitin 2015, kjo me arsyetimin se,

faturat nga të cilat rrjedhin këto shpenzime qoftë nuk e kanë pasur të specifikuar në të numrin fiskal, qoftë për arsye se nuk kanë hasur në kopje të certifikatës së biznesit, apo certifikatës të TVSH-së. E para për nga aspekti faktik këto pretendime janë tërësisht të pa sakta dhe dëshmohet nga vet regjistrat publik të ATK-së. Për qëllim të sqarimeve të pretendimeve tona i dorëzojmë katër grupe të provave që duhet të administrohen. Në lidhje me provën nr. 2, dëshmohet se të gjitha këto shpenzime të cilat nuk janë njohur, janë shpenzime të cilat rrjedhin nga tenderët publik të zhvilluar në përputhje me legjislacionin e Kosovës, nëse shihni provën e parë, vërtetimin tatimor nga ATK-ja, pikërisht shpenzimet e kësaj Kompanie që në këtë fazë nuk i njeh, për të njëjtën kompani ka lëshuar vërtetim tatimor, përmes të cilit konfirmon se është tatimpagues i rregullt, ka numër fiskal dhe të TVSH-s, dhe nuk është nën vones të pagesës tatimore. Ngjashëm në grupin e provave 2, janë të bashkangjitura certifikatat e biznesit, certifikatat e numrave fiskal dhe certifikatat e TVSH-së, të konfirmuara nga vet ATK-ja që dëshmojnë se pretendime se këto kompani nuk kanë numra fiskal nuk është i sakt. Prej grupit të provave nr. 3, kemi bashkangjitur në cilësinë e provave të gjitha faturat që nuk janë njohur, dhe më e rëndësishmja të gjitha kopjet e transaksioneve bankare për secilën faturë, që dëshmojnë se pagesat kanë qenë në përputhje me Ligjin ne Bankat e Kosovës. Përfundimisht përmes provës nr.1, gjithashtu janë bashkangjitur Raportet e kontrollit të ATK-së, për periudhën 2013/2014, ku për të njëjtën qështje për të njëjtin model të faturave i kanë njohur si shpenzime të rregullta në përputhje me Ligjin. Për më tepër aplikimi i standardit të dyfishtë është edhe fakti se të gjitha këto kompani në shpenzimet të cilat nuk i njeh ATK-ja tek “T.” i ka njohur si hyrje të rregullta tek bizneset që kanë pranuar mjete. Në lidhje me këto fakte duhet të aplikohet neni 13 të Ligjit për ATK-në në lidhje me nenin 20 par. 1.2 dhe 1.3, që tregojnë dhe në mënyrë specifike përcaktojnë se, citoi: “në praktik mund të ketë forma të ndryshme të faturave, por pa marrë parasysh formën me rëndësi janë përmbajtja e të dhënave esenciale financiare” dhe në këtë drejtim vet pagesa bankare që është bazë e mjaftueshme për njohjen e këtyre shpenzimeve, për arsye se kjo njihet edhe me Ligjin mbi TVSH-në si moment i lindjes së detyrimit. Pas kërkesës për ekspertizë financiare ne pajtohemi me konstatimet e ekspertit financiar, dhe vlerësojmë që në përputhje me gjetjet e ekspertizës kjo lëndë edhe mund të vendoset në mënyrë meritore nga ana e gjykatës. Në këtë drejtim konstatimet kryesore të ekspertizës janë në linjë me pretendimet në padi, ku dy konstatimet kryesore përfshijnë konstatimet dhe analizat e bëra në faqe 11 par. 1 dhe par. 2, në këtë drejtim ekspertiza financiare konstaton se faturat e verifikuara dhe të paraqitura në shtojcën 2, janë vlerat e pagesave të harmonizuara me vlerat e faturave, për më tepër ekspertiza gjithashtu ka konstatuar se pagesat janë bërë në Bankat e licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës. E konstatimi i dytë gjithashtu pajtohemi me ekspertizën financiare e cila ka konstatuar se, për faturat e verifikuara dhe të paraqitura në shtojcën 2, e për të cilat ATK-ja nuk ka pranuar shpenzimet 2014-2015 janë të subjekteve që kanë pasur të paraqitur numrat fiskal dhe kanë kryer obligimin mujor të deklarimit të TVSH-së. Përfundimisht sikurse ka konstatuar edhe eksperti ATK-ja nuk ka ofruar asnjë provë që për periudhën kontestuese këta tatimpagues kanë qenë të klasifikuar si tatimpagues jo aktiv. Për periudhën në fjalë, dhe rrjedhimisht duke qenë se ATK-ja nuk ka ofruar dëshmi të tilla për deri sa paditësi ka ofruar dëshmi dhe certifikata të TVSH-së të tilla të njëjtit nuk mund të konsiderohen si tatimpagues jo aktiv. Përfundimisht pajtohemi edhe me konstatimet e ekspertit se në shumicën e faturave ATK-ja ka konstatuar në mënyrë të gabuar se mungon numri fiskal i furnitorit edhe pse numrat e tillë, kanë qenë pjesë e faturave. Andaj, në këtë drejtim vlerësojmë se në përputhje të gjendjes faktike të konstatuar edhe nga eksperti dhe në përputhje me provat e bashkangjitura dëshmohet qartë se vendimi i ATK-së, është i pa ligjshëm.

E paditura në përgjigjen në padi datës 20.06.2020, ka deklaruar se e kontestojm në tërësi kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar. ATK ka kryer kontrollin për paditësin bazuar në legjislacionin tatimor dhe aktet tjera në fuqi si dhe dokumentacionin si: librat e shitblerjes, faturat e blerjes dhe shitjes, libri i shpenzimeve, librin e arkës, faturat hyrëse, llogarit bankare etj. Kontrolli është kryer pas kërkesës për rimbursim. Kontrolli është kryer bazuar në provat e siguruar sipas

legjislacionit tatimor dhe ka rezultuar me detyrime në TVSH, TAK dhe ËR. ATK konstaton se pretendimi i paditësit është i pabazuar lidhur me faturat sepse ATK lidhur me trajtimin e këtyre faturave është mbështetur në legjislacionin tatimor përkatësisht neni 13 të Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat si dhe nenin 20 të Udhëzimit Administrativ

15/2010, neni 37 dhe 45 të Ligjit 03/L-146 për TVSH. ATK ka konstatuar se faturat të cilat nuk janë pranuar nuk i plotësojnë kushtet e parapara sipas legjislacionit tatimor pra nuk i plotësojnë elementet që duhet të posedoj një faturë për tu konsideruar e rregullt dhe për tu pranuar si shpenzim. Faturat nuk janë në përputhje me nenin 45.1 dhe nenin 37 të Ligjit 03/L-146 për TVSH. Kontrolli ka konstatuar se 18 biznese kanë lëshuar fatura jo të rregullta dhe parregullsi tjera lidhur me mos zbatimin e legjislacionit tatimor në fuqi. Vendimi i ATK-së është mbështetur edhe në nenin 29.2 të U.A. nr.15/2010 sipas të cilit ATK-ja është e autorizuar për të vlerësuar tatimin në rastet kur në deklarata nuk është paraqit në mënyrë të saktë detyrimi tatimor. Andaj i propozojmë gjykatës që pas administrimit të provave të marr aktgjykim me të cilën refuzohet në tërësi si e pabazuar padia dhe kërkesëpadia e paditëses duke lënë në fuqi vendimin e D.A. të ATK-së nr.87/2016 të datës 23.05.2016.

Gjykata ka shqyrtuar këtë konflikt administrativ gjyqësor konform dispozitave të nenit 41 të LKA-së, për arsye se pala e paditur me parashtrësën e datës 15.06.2020 e ka njoftuar gjykatën se nuk do të prezantoj në seancën gjyqësore dhe propozon që të vepohet konform neni 38.5 të LKA-së (provë: parashtrësja e datës 15.06.2020 nga ATK-së).

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit publik të datës; 22.06.2020, ka administruar provat relevante dhe atë: përgjigja në padi e dt.20.06.2020 e ATK-së, vendimi nr.87/2016 i dt.23.05.2016 i ATK-së, Raporti i Kontrollit, çertifikata e Biznesit, çertifikatat e Regjistrimit, çertifikata-Deklaruese e TVSH-së dt.30.03.2015, vërtetimi tatimor nr.1000219064 i ATK-së, faturat tatimore, Dëshmitë Bankare të pagesave, ekspertiza financiare e dt.03.02.2020, Dokumentacioni shtesë, Draft kontrata, Kundërshtimi i ekspertizës financiare dt.15.06.2020 i ATK-së.

Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 81G të Ligjit NR.04/1-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës, bëri ballafaqimin e provave të siguruara në konfliktin administrativ, dhe në bazë të vërtetimit të gjendjes faktike, gjeti se kërkesëpadia është e pabazuar.

Nga provat e administruara gjykata konstaton se e paditura ka vepruar drejt kur me vendimin kontestues ka refuzuar ankesën e paditëses dhe ka konfirmuar si të bazuara Njoftim Rivlerësimet e kontrollit, me të cilat janë bërë ndryshimet në periudhat e kontrollës 03/2014-07/2015 në TVSH, TAK 2014 dhe WM, CM 03/2014-07/2015. Tatimi shtesë ka ardhur si rezultat i mos pranimit të shpenzimeve të afarizmit, të bizneseve të peregjistruara, faturave fiktive dhe faturave të parregullta blerëse për qëllime të TVSH-së.

Gjykata nuk ka gjetur dëshmi që do të mund të ndryshonte një gjendje tjetër faktike nga gjendja që ka konstatuar e paditura në procedurën administrative të ankesave dhe atë të kontrollit, për arsye se paditësja as në këtë procedurë të konfliktit administrativ nuk i ka ofruar gjykatës prova materiale për të mbështetur pretendimet se ekzistojnë transaksionet me subjektet tjerë nga të cilët është furnizuar me shërbime të ndryshme sipas faturave tatimore blerëse që gjenden në lëndë 2014 dhe 2015. Transaksionet e blerje shitjeve në këtë rast i takojnë subjektëve që nuk janë të regjistruar me numra fiskal obligim ky që parashihet me nenin 11 të Ligjit 03/L-222 për Administratën tatimore

dhe Procedurat, ku thuhet: çdo person i cili i nënshtrohet ndonjë lloj tatimi të administruar nga ATK do të regjistrohet në ATK dhe do të marrë një numër fiskal para se të angazhohet në ndonjë veprimtari ekonomike.

Kjo gjendje faktike ka rezultuar gjatë verifikimit të blerjeve të paditësit, i cili ka realizuar transaksione me subjektë që nuk janë të pajisur me numra fiskal dhe të cilat subjekte nuk kanë deklarime të asnjë lloj tatimeve që kërkohet me legjislacionin tatimor. Këtë gjendje të shpenzimeve të papranuara për subjektët në fjalë janë paraqitur nga Kontrolli detalisht në Raportin e Kontrollit faqe 7. Gjithashtu në Raportin e Kontrollit janë hasur në parregullsi të faturave blerëse sikurse janë ato të subjektit R..., të cilat fatura nuk kanë të evidentuara numrat fiskal dhe numrin e tvsh-së, dhe i njëjti subjekt që nga muaji prill 2014 ka qarkullim 0.00€. Prandaj edhe gjykata pranon konstatimet e të paditurës në arsyetimin e vendimit kontestues se provat e paraqitura nga paditësi para kontrollit nuk i plotësojnë elementet ashtu siç i parasheh neni 13 paragrafi 1 të Ligjit 03/L-222 për Administratën tatimore dhe Procedurat, ku parashihet: Tatimpaguesit janë të detyruar të mbajnë librat dhe regjistrat në pajtim me legjislacionin tatimor.

Meqenëse gjykata nuk posedon dëshmi se janë realizuar pagesat në emër të faturave kontestuese, në këtë rast gjykata i pranon qëndrimet e të paditurës për mos pranimin e këtyre faturave tatimore blerëse. Gjkata në këtë rast nuk i ka konsideruar si të mjaftueshme pretendimet e paditëses se faturat tatimore kontestuese i plotësojnë kërkesat ligjore sikurse parashihet me nenin 45.1 dhe nenin 37 të Ligjit nr.03/L-146 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, prandaj gjykata nuk ia fali besimin ekspertizës financiare datës 03.02.2020 në pikën e parë të mendimit profesional faqe 12, që të bëhet rivlerësimi i gjendjes faktike të bizneseve dhe mos pranimit i shpenzimeve për vitet 2014-2015 bazuar në paraqitjet tabelare. Gjkata ka konstatuar se në ekspertizë jepet vlerësimi se faturat e kontestuar nga ATK-ja të 4 subjektëve, kanë patur të paraqitur numrat fiskal dhe kanë kryer obligimin mujor të deklarimit të TVSH-së. Gjkata nuk mundi të pranojë si të rregullta shpenzimet e faturave tatimore për vitet 2014-2015 të cilat kanë parregullsi në përmbajtje, përderisa në ekspertizën financiare ky vlerësim është bërë pjesërisht vetëm në katër subjektë që kanë pasur numra fiskal. Fakti se kemi të bëjmë me një numër të konsiderueshëm të faturave blerëse që nuk i plotësojnë kriteret ligjore që kërkohen me ligjin e TVSH-së për tu pranuar tvsh e zbritshme, gjykata nuk i konsideroi si të mjaftueshme këto vlerësime që të bëhet sërish një ri-vlerësim i gjendjes faktike të faturave tatimore kontestuese nga kontrolli i ATK-së.

Gjkata e vlerësoi të drejt vlerësimin e kontrollit dhe konstatimin e të paditurës në arsyetimin e vendimit kontestues lidhur me të hyrat shtesë për vitin 2014 të konstatuara nga kontrolli paraprak. Paditësi nuk ka prezantuar as para ekspertit financiar raportin e kontrollit të fundit dhe as provat tjera për ti kundërshtuar vlerësimet e Kontrollit tatimor se për vitin 2014 qarkullimi sipas kontrollit në vlerë prej 12,951,017,74€, është më i lartë për 158.136,69€ në krahasim me qarkullimin e vet deklaruar nga paditësi në vlerë prej 12.792,881,05€.

Në bazë të gjendjes faktike, ballafaqimit dhe ekzaminimit të provave në procedurën e konfliktit administrativ gjyqësor, gjykata vlerëson se vendimi nr.87/2016 datë 23.05.2016 i Departamentit të Ankesave i ATK-së, është vendim i drejtë dhe i bazuar në dispozita ligjore.

Gjykata bazuar në autorizimet nga neni 81.I par.2 pika 2.3 të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222 dhe neni 43 par.2 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për çështje administrative-Divizioni Fiskal
A.nr.1012/16 datë 22.06.2020

Gjyqtari,
Krenar Berisha

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 60 ditësh nga marrja e të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.